



**Akademia e Kosovës për Siguri Publike**  
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety

**Divizioni për Sigurimin e Cilësisë**  
Odeljenje za osiguranje kvaliteta/Division for Quality Assurance

---

# Raport i përgjithshëm vjetor i vlerësimit të trajnimeve për vitin 2022



## Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	3
Hyrja .....	4
Divizioni për Sigurimin e Cilësisë - DSC.....	5
Realizimi i pyetësorëve .....	5
Të gjeturat e përgjithshme .....	6
Të gjeturat sipas kategorizimit të trajnimeve.....	7
Trajnimet Profesionale.....	8
Trajnimi profesional “Zyrtar Policor” .....	9
Trajnimi profesional “Zyrtar Korrektues” .....	11
Trajnimet Bazike.....	13
Trajnimet e Avancuara.....	17
Trajnimet e Specializuara .....	20
Trajnimet për Instruktor .....	21
Të gjeturat sipas trajnimeve për ISP .....	23
Policia e Kosovës .....	23
Shërbimi Korrektues i Kosovës .....	29
Shërbimi Sprovues i Kosovës .....	30
Dogana e Kosovës.....	31
Agjencia e Menaxhimit Emergjent .....	32
Inspektorati Policor i Kosovës .....	33
Të gjeturat sipas trajnimeve të ofruara nga Partnerët Ndërkombëtar .....	34
ICITAP.....	34
OSBE .....	34
Trajnimet të ofruara nga Akademia .....	35
Komentet e përmbledhura.....	37
Rekomandimet e përmbledhura .....	38
Shtojca 1- Taksonomia e Bloomit.....	39

## Lista e shkurtesave

AKSP: Akademia e Kosovës për Siguri Publike

ISP: Institucionet e Sigurisë Publike

PK: Policia e Kosovës

IPK: Inspektorati Policor i Kosovës

AME: Agjencia e Menaxhimit Emergjent

SHKK: Shërbimi Korrektues i Kosovës

SHSK: Shërbimi Sprovues i Kosovës

DK: Doganat e Kosovës

OSBE: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

ICITAP: Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin e Hetimeve Kriminale

IADLEST: Asociacioni Ndërkombëtar i Drejtorëve të Zbatuesve të Ligjit, Trajnimit dhe Standardet

MASHT: Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

AKK: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

KAAPRr: Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe për të Ritur

KKK: Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

KEK: Korniza Evropiane e Kualifikimeve

IAAP: Institucion i Arsimit dhe Aftësimin Profesional

DTPA: Departamenti i Trajnimeve dhe Përkrahjes Arsimore

DT: Divizioni i Trajnimeve

DSHS: Divizioni i Shërbimeve Studentore

DSC: Divizioni për Sigurim të Cilësisë

ECVET: Sistemi Evropian i Kredive për Aftësim dhe Arsim Profesional

## Hyrja

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (në tekstin e mëtejme Akademia) është institucion i formuar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. Në kuadër të strukturës organizative të Akademisë, si shtyllë kryesor e saj funksionon Departamenti për Trajnime dhe Përkrahje Arsimore me divizionet përbërëse të cilat kanë mision ofrimin dhe koordinimin e trajnimeve, zhvillimin e kurrikulave të programeve trajnuese si dhe ofrimin e shërbimeve për vijues në kuadër të trajnimeve që ofrohen në Akademi.

Siq edhe është e përcaktuar me ligj e Akademisë ofron programe trajnuese në fushën e sigurisë publike. Akademia ofron trajnime për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- *Policinë e Kosovës;*
- *Shërbimin Korrektues;*
- *Shërbimin Sprovues;*
- *Doganën e Kosovës;*
- *Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;*
- *Inspektoratin Policor të Kosovës;*

**Trajnimet në Akademi** - Krahas aprovimit të Ligjit të Akademisë-së në dhjetor të vitit 2011, Komisioni Evropian ka aprovuar dhe financuar Projektin e Binjakëzimit me titull: “*Përkrahja e mëtejme e arsimit të sigurisë publike në Kosovë*” implementuar nga Finlanda dhe Estonia. Përmes projektit të binjakëzimi u bë e mundur krijimi dhe aprovimi i standardeve të profesionit në përputhje të plotë me Kornizën Kombëtare të Kualifikimit - KKK, e cila i hapi rrugën akreditimit institucional të Akademisë si Institucion ofrues i Arsimit dhe Aftësisit Profesional- IAAP me trajnime profesionale të validuara.

**Sigurimi i cilësisë në Akademi** - është pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm për të gjitha proceset dhe aktivitetet në Akademi. Sistemi i zbatuar i cilësisë jep një pasqyrë të parimeve të menaxhimit të cilësisë në Akademi dhe tregon se si ato parime mund ta përbëjnë bazën për përmirësimin e performancës dhe përsosjes organizative.

Parimi i përmirësimit të vazhdueshëm është parimi kryesor dhe pjesë e vizionit të Akademisë. Në këtë frymë janë krijuar pyetësor në cilësinë e mekanizmave matës dhe përmirësues në fushën e trajnimeve duke e vendosur pjesëmarrësin në qendër.

Përgjatë vitit 2022, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda Akademisë, DSC-ja ka realizuar vlerësimin e të gjitha trajnimeve me kompetencë në kuadër të Akademisë. I gjithë procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur kredibilitetin dhe prestigjin e institucionit.

## Divizioni për Sigurimin e Cilësisë - DSC

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë është një divizioni i cili në veprim është i pavarur dhe funksionon nën Zyrën e Drejtorit të përgjithshëm të Akademisë dhe raporton direkt tek drejtori i përgjithshëm i Akademisë. DSC angazhohet në rritjen e cilësisë në Akademi duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentet matës të cilësisë të aprovuar në doracakun e cilësisë i cili rishikohet në baza të rregullta periodike konform ndryshimeve të reja dhe azhurnimeve të reja akterët relevant për të cilat DSC ofron raportet vlerësuese. DSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Drejtori i përgjithshëm i Akademisë, Drejtori i DTPA-së dhe akterëve relevant me qëllim të planifikimit të zhvillimit të mëtutjeshëm të fushës së trajnimeve.

## Realizimi i pyetësorëve

DSC bazuar në mandatin e saj dhe dokumenteve strategjike e vjetor të cilat i definojnë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e DSC në formë të vazhdueshme ka zhvilluar matje dhe vlerësime përmes pyetësorëve-formularëve të vlerësimit dhe të njëjtat i ka adresuar tek kanalet zyrtare duke zhvilluar pastaj edhe takime me përgjegjësitë/koordinatorët e trajnimeve për analizimin e të dhënave të fituara nga informatat kthyesë të pranuar nga pjesëmarrësit në trajnime përgjatë vitit 2022.

Pyetësorët kanë qenë anonim dhe i formatit elektronik i adresuar përmes platformës së domenit [dsc.aksp@aksp-ks.org](mailto:dsc.aksp@aksp-ks.org) tek e-mail adresa e pjesëmarrësve e cila njëherësh është e ndërlidhur me përpunimin e të dhënave elektronike duke shfrytëzuar sistemet e licencuara të google forms.


Vijuesit janë përgjigjur përmes sistemit elektronik dhe atij fizik (në trajnime në terren) i cili në kuadër të një pyetësorit për vlerësimin e trajnimit në fjalë. Pyetësi përmban 10 pyetje nga fusha e vlerësimit të mësimnxënies, materialit mësimor, pjesës praktike, vlerësimin e trajnuesit/instruktorit, vlerësimin e mjeteve lehtësuese në dispozicion përgjatë trajnimit si dhe shërbimeve të ofruara përgjatë trajnimit.

## Të gjeturat e përgjithshme

Akademia bazuar në planin vjetor të trajnimeve për vitin 2022 në prezantimin e nevojave të ISP-ve për trajnimin e stafit, ka paraqitur dhe aprovuar planin e trajnimeve dhe të njëjtin ka implementuar në kuadër të politikave strategjike të ISP-ve në përputhje me kërkesat dhe nevojat e ngritjes së kapaciteteve të sigurisë publike.

DSC ka analizuar raportet vjetore të trajnimeve të realizuara e të matura dhe paraqet këto të gjetura si në vijim për trajnimet e realizuara në sipas planit të trajnimeve për vitin 2022.

Plani i trajnimeve për vitin 2022	Planifikuara		Realizuara			
	trajnime	vijues	trajnime	vijues	% trajnime	% vijues
Policia e Kosovës	41	973	50	1074	121.95%	110.38%
Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave	14	308	9	149	64.29%	48.38%
Inspektorati Policor i Kosovës	7	110	0	0	0.00%	0.00%
Shërbimi Korrektues i Kosovës	25	415	10	167	36.00%	32.53%
Shërbimi Sprovues i Kosovës	6	150	0	0	0.00%	0.00%
Dogana e Kosovës	12	240	3	43	25.00%	17.92%
ICITAP	4	90	1	35	25.00%	38.89%
OSBE	6	125	4	68	66.67%	54.40%
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	15	275	9	185	60.00%	67.27%
<b>Gjithsej</b>	<b>130</b>	<b>2686</b>	<b>86</b>	<b>1721</b>	<b>66.15%</b>	<b>64.07%</b>



Akademia ka planifikuar 130 trajnime sipas planit vjetor të trajnimeve për vitin 2022, ndërsa ka realizuar 86 trajnime ose 66.15% të trajnimeve të realizuara.

Nga totali prej 86 trajnimeve të realizuara nga plani vjetor i trajnimeve, neve në kuadër të politikave vlerësuese për vlerësimin e trajnimeve që ofrojnë kompetencë kemi vlerësuar **76 trajnime të realizuara për vitin 2022**. Po ashtu në kohë simultante kemi vlerësuar edhe dy trajnime profesionale me këto të dhëna si në vijim:

- *Trajnimi profesional “Zyrtar Policor” me gjithsejtë 447 kadetë, dhe*
- *Trajnimi profesional “Zyrtar Korrektues” me gjithsejtë 48 kadetë.*

Andaj në total kemi vlerësuar 76 trajnime me gjithsejtë 1542 respondent, ose kemi pranuar 15420 përgjigje me 1542 komente në total, me nivelin e arritur të kënaqshmërisë prej 93.81% ose notë mesatare prej 4.68.

Të gjitha të gjeturat të cilat janë ofruar nga përgjigjet e pjesëmarrësve/vijuesve kanë qenë të dhëna të sinqerta të ofruara në vlerësim, koment dhe propozimet e tyre kanë treguar se pjesëmarrësit në trajnime janë pjesa thelbësore në kontributin e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm në kuadër të proceseve në Akademi. Raportet individuale për secilin trajnim janë adresuar në kohë reale duke e përcjellë edhe me takime analizuese me koordinatorët e trajnimeve për hapat e mëtutjeshëm.

Për të ofruar të dhëna më të detajuara, më poshtë do gjeni të gjeturat e ndara në raportin e përgjithshëm të vlerësimit të trajnimeve për vitin 2022 të ndarë sipas kategorizimit të trajnimeve në Akademi si dhe sipas ISP-ve për të cilat është ofruar trajnimi. Ky raport njëherësh shprehë statistikën e përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e informatave kthyesë në nivel të trajnimeve.

### [Të gjeturat sipas kategorizimit të trajnimeve](#)

Kategorizimi i Trajnimeve në Akademi është i bazuar në nivelin e shkathtësive dhe aftësive të konkretizuar me kompetencë të ngritjes profesionale. Bazuar në këtë parim, Akademia ka bërë këtë kategorizim të trajnimeve si në vijim:

- *Trajnimet Profesionale*
- *Trajnimet Bazike*
- *Trajnimet e Avancuara*
- *Trajnimet e Specializuara*
- *Trajnime për Instruktor*

## Trajnimet Profesionale

Kjo kategori e trajnimeve paraqet procesin e hapave të parë që ndërlidhen me një karrierë apo drejtim specifik të profesionit. Trajnimi profesional fokusohet në aplikimet praktike të aftësive të mësuara dhe në përgjithësi arrin ndërlidhjen e aplikimit të saj në praktikë. Një pjesë e madhe e arsimit në shkollat profesionale është trajnimi praktik. Trajnimi profesional është i bazuar në standardet e profesionit të aprovuara nga Këshilli Drejtues i AKK si parakusht i zhvillimit dhe të cilat si kualifikim janë të sistemuara në kuadër të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve e cila del nga Korniza Evropiane e Kualifikimeve. Akademia bazuar në mandatin e saj ka të aprovuara këto standarde të profesionit nga Këshilli drejtues i AKK-së pas fazës ri shqyrtuese nga KAAPRr i MASHT-it si në vijim:

STANDARDET E APROVUARA NGA AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE							
Standardet profesionale	Sektori	Zhvilluar	AKK	Riverifikuar	Kodi	Niveli KKK	Valide
Inspektor i Inspektoriatit Policor të Kosovës	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	3355	5	5/30/2026
Zyrtar Korrektues	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	5413	5	5/30/2026
Zyrtar Sprovues	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	2635	5	5/30/2026
Zyrtar Doganor	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	3351	4	5/30/2026
Zyrtar Policorë	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	5412	5	5/30/2026
Zjarrfikës	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	6/25/2021	5411	4	6/24/2026

Institucioni i akredituar me trajnimet profesionale të validuara nga këshilli drejtues i AKK-së.

IAAP	KUALIFIKIMI	NIVELI	KREDITË	VENDIMI	AFATET
Akademia e Kosovës për Siguri Publike AKSP	Zyrtar Policor	V	72	7/24/2021	7/23/2024
	Inspektor i inspektoratit Policor të Kosovës	V	83	7/24/2021	7/23/2024
	Zyrtarë Doganor	IV	68	7/24/2021	7/23/2024
	Zyrtarë Korrektues	V	60	7/24/2021	7/23/2024
	Zyrtarë Sprovues	V	34	7/24/2021	7/23/2024
	Zjarrfikës	IV	80	7/24/2021	7/23/2024

TRAJNIMET PROFESIONALE					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuar	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi profesional Zyrtar Policor	1	447	7 muaj	71.68%	3.59
Trajnimi profesional Zyrtar Korrektues	1	48	7 muaj	92.73%	4.64



## Trajnimi profesional “Zyrtar Policor”


Trajnimi profesional i validuar në përputhje me planin vjetor të trajnimeve pas hapave rekrutues që zhvillohen nga vetë ISP-ja respektive dhe përgatitjeve që Akademia zhvilloj në koordinim me PK, me datë 12 Korrik 2022 filloj gjenerata e 57 e trajnimit profesional “ Zyrtar Policor” me gjithsejtë 447 kadetë të deklaruar. Akademia zhvilloj planin dinamik të implementimit të trajnimit profesional në përputhje me obligimet që IAAP ka ndaj AKK-së me rastin e fillimit të gjeneratës së re, si caktimi i Koordinatorit të trajnimit nga Akademia dhe ISP-ja respektive si dhe Koordinatorin e Cilësisë nga Akademia. Po ashtu në kuadër të obligimeve Akademia ofroj listën e deklarimit të grupeve të kandidateve dhe stafit, si dhe planin e ofrimit të kualifikimit (*shtrirja e orëve sipas ditës, javës, si dhe muajit*).

Trajnimi profesional iu nënshtrua këtyre mekanizmave vlerësues gjatë fazës implementuese si në vijim:

- Vlerësimi i modulit nga ana e kadetëve
- Vlerësimi i trajnerit/instruktorit nga ana e kadetëve
- Vlerësimi i mjedisit arsimor nga ana e kadetëve si dhe
- Vlerësimi i moduleve nga ana e trajnerëve/instruktorëve bartës të modulit

Nga totali i përgjithshëm kemi këto të dhëna të fituara si në vijim:

<b>Trajnimi profesional Zyrtar Policor</b>		
<b>Fusha e vlerësuar</b>	<b>Mesatarja e kënaqshmërisë</b>	<b>Nota mesatare</b>
Vlerësimi i përgjithshëm i moduleve nga ana e kadetëve	<b>72.18%</b>	<b>3.62</b>
Vlerësimi i stafit trajnues/instruktor nga ana e kadetëve	<b>72.77%</b>	<b>3.66</b>
Vlerësimi i mjedisit arsimor nga ana e kadetëve	<b>70.08%</b>	<b>3.50</b>



**Të gjeturat:** programi trajnues gjatë fazës implementuese ka qenë i modifikuar në aspektin e implementimit në kohë, meqë numër i lartë i pjesëmarrësve që filluan në të njëjtën ditë nuk përkonte me kapacitetet e stafit trajnues për modul të shpërndarë në 14 klasë mësimi. Andaj në kuadër të kapaciteteve njerëzore dhe atyre infrastrukturore janë bërë modifikime në orar i cili ka respektuar kushtet e përcaktuara me kurrikulë të qasjes së modulet gjegjëse edhe pse në fazën implementuese sfidat kanë qenë gjithnjë prezente.

**Rekomandim:** Rekomandojmë AKSP që në fazën e planifikimeve të trajnimeve profesionale të ri aranzhohet mundësia e fillimit të gjeneratave me numër më të vogël dhe të shpërndarë përgjatë vitit duke ofruar mundësinë e ndjekjes së moduleve në vazhdimësi. Përkundër faktit që vendimi i AKK definon qartë që mund të ketë 2 gjenerata me jo më shumë se 500 pjesëmarrës për gjeneratë dhe jo në të njëjtën kohë gjatë vitit kalendarik, ne vlerësojmë se ngarkesa e stafit trajnues mundësitë infrastrukturore të Akademisë nuk përkojnë me strategjitë e njëanshme të PK-së, përkundër pjesëmarrjes së kësaj të fundit në punëtorinë e prezantimit dhe koordinimit të nevojave trajnuese në Akademi në planit vjetor të trajnimeve.

**Rekomandim:** Plani i ANT-së për trajnimin profesional të jetë i koordinuar me Akademinë dhe në rivaldimin e radhës së trajnimit profesional të rishikohet programi sipas pjesëve të identifikuara si nevojë për ndryshim, posaçërisht mungesa e pjesës së internshipit e cila është kusht për trajnimet e validuara. Ne e vlerësojmë faktin që trajnimi fushor është 1 vjeçar që ofrohet në PK, mirëpo Akademia duhet të jetë pjesë e zhvillimit të pjesës së internshipit duke krijuar rrjetin e mentorëve, koordinatorin e internshipit dhe të zbatohet doracaku i pjesës praktike të trajnimeve profesionale. Njëherësh rekomandojmë që gjatë planifikimit të nevojave trajnuese, shpërndarja e kapaciteteve trajnuese për trajnim të ketë balancim me ISP-të tjera që ndjekin trajnim në Akademi duke ofruar hapësirë për zhvillim, rishikim dhe azhurnim të kurrikulave trajnuese të kategorive tjera trajnuese që ofrohen në Akademi.

## Trajnimi profesional “Zyrtar Korrektues”


Trajnimi profesional i validuar në përputhje me planin vjetor të trajnimeve pas hapave rekrutues që zhvillohen nga vetë ISP-ja respektive dhe përgatitjeve që Akademia zhvilloj në koordinim me SHKK, me datë 27 Qershor 2022 filloj gjenerata e 42 e trajnimit profesional “ Zyrtar Korrektues” me gjithsejtë 48 kadetë të deklaruar. Akademia zhvilloj planin dinamik të implementimit të trajnimit profesional në përputhje me obligimet që IAAP ka ndaj AKK-së me rastin e fillimit të gjeneratës së re, si caktimi i Koordinatorit të trajnimit nga Akademia dhe ISP-ja respektive si dhe Koordinatorin e Cilësisë nga Akademia. Po ashtu në kuadër të obligimeve Akademia ofroj listën e deklarimit të grupeve të kandidateve dhe stafit, si dhe planin e ofrimit të kualifikimit (shtrirja e orëve sipas ditës, javës si dhe muajit).

Trajnimi profesional iu nënshtrua këtyre mekanizmave vlerësues gjatë fazës implementuese si në vijim:

- Vlerësimi i modulit nga ana e kadetëve
- Vlerësimi i trajnerit/instruktorit nga ana e kadetëve
- Vlerësimi i mjedisit arsimor nga ana e kadetëve si dhe
- Vlerësimi i moduleve nga ana e trajnerëve/instruktorëve bartës të modulit

Nga totali i përgjithshëm kemi këto të dhëna të fituara si në vijim:

<b>Trajnimi profesional Zyrtar Korrektues</b>		
<b>Fusha e vlerësuar</b>	<b>Mesatarja e kënaqshmërisë</b>	<b>Nota mesatare</b>
Vlerësimi i përgjithshëm i moduleve nga ana e kadetëve	<b>91.70%</b>	<b>4.58</b>
Vlerësimi i stafit trajnues/instruktor nga ana e kadetëve	<b>97.00%</b>	<b>4.85</b>
Vlerësimi i mjedisit arsimor nga ana e kadetëve	<b>89.50%</b>	<b>4.48</b>



**Të gjeturat:** programi trajnues gjatë fazës implementuese është zhvilluar në përputhje të plotë kohore dhe të shtrirjes së trajnimit profesional meqë numri i kadetëve ka përkuar me numrin e stafit trajnues.

Gjatë fazës implementuese e vetmja sfidë ka qenë pjesa e kuzhinës e cila përkundër numrit të lartë të trajnimeve tjera sidomos atij nga PK, ka bërë që koha e dedikuar për ushqim të modifikohet andaj kemi regjistruar raste të modifikimit të disa shërbimeve të ofruara në akademi, por asnjëherë në mungesë.

**Rekomandim:** plani i ANT-së për trajnimin profesional të jetë i koordinuar me Akademinë dhe në rivalidimin e radhës së trajnimit profesional të rishikohet programi pjesët e identifikuar si nevojë për ndryshim. Po ashtu rekomandojmë që të digjitalizohet sistemi i të dhënave dhe listave në SHKK duke i ofruar Akademisë informatë më të shpejtë rreth kadetëve dhe përmbushjes së obligimeve ndaj AKK si deklarimi i stafit dhe i pjesëmarrësve në trajnim, e cila për këtë gjeneratë ka qenë pak e vonuar.


## Trajnimet Bazike

Kjo kategori e trajnimit paraqet procesin e marrjes së njohurive bazike në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike, të cilat ballafaqohen me detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse gjatë ushtrimit të profesionit të tyre për profilin profesional në sektorët e ndryshëm të ISP-ve respektive.

<b>TRAJNIMET BAZIKE</b>					
<b>Emri i trajnimit</b>	<b>Numri i trajnimeve të realizuar</b>	<b>Numri i vijuesve</b>	<b>Kohëzgjatja e trajnimit</b>	<b>Mesatarja e kënaqshmërisë</b>	<b>Nota mesatare</b>
Trajnimi Themelor i Hetimeve të Krimin	2	53	19 ditë	<b>72.18%</b>	<b>3.62</b>
Kursi i Policisë në Bashkësi	1	13	10 ditë	<b>72.77%</b>	<b>3.66</b>
Heckler dhe Koch MP-5	1	12	5 ditë	<b>91.70%</b>	<b>4.58</b>
Trajnimi për Njësinë Speciale Intervenuese	1	15	60 ditë	<b>97.00%</b>	<b>4.85</b>
Trajnimi Bazik i Policisë Kufitare - Frontex	1	20	19 ditë	<b>89.50%</b>	<b>4.48</b>
Trajnimi Intervista Motivuese	1	12	3 ditë	<b>92.86%</b>	<b>4.64</b>
Trajnimi Bazik në Zjarrfikje dhe Shpëtim	3	59	9/10 ditë	<b>94.47%</b>	<b>4.76</b>
Kursi Vlerësimi i Rreziqeve	1	15	3 ditë	<b>93.56%</b>	<b>4.68</b>
Trajnimi Shuarja e Zjarreve Fushore dhe Malore	3	40	3 ditë	<b>95.31%</b>	<b>4.77</b>
Trajnimi Zjarret e Brendshme dhe Shuarja e Tyre	1	15	5 ditë	<b>98.75%</b>	<b>4.94</b>
Trajnimi Aksidentet e Komunikacionit Rrugor	1	20	5 ditë	<b>98.00%</b>	<b>4.90</b>
Menaxhimi i Vijës së Parë	1	20	20 ditë	<b>98.90%</b>	<b>4.95</b>
Trajnimi Gjuha Angleze - Niveli Fillestar	1	11	10 ditë	<b>97.45%</b>	<b>4.87</b>
Trajnimi Elementet Bazë të Menaxhimit	2	41	5 ditë	<b>97.80%</b>	<b>4.89</b>
<b>Trajnimet bazike të realizuara jashtë kampusit të Akademisë</b>					
Trajnimi Themelor për Pistoletën Glock 9x19 (SHKK)	3	37	5 ditë	<b>94.05%</b>	<b>4.63</b>
Trajnimi Qendra e Ndalimit (PK)	1	19	5 ditë	<b>70.00%</b>	<b>3.50</b>
Trajnimi Themelor i Hetimeve të Krimin (PK)	2	78	19 ditë	<b>60.45%</b>	<b>3.09</b>

Zbërthimi i trajnimeve bazike si në vijim:

- 26 trajnime bazike,
- 480 vijues në total,
- 89.10% mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.46 nota mesatare.



Nga totali i 26 trajnimeve bazike të vlerësuara:

- 20 trajnime janë mbajtur në kampusin e Akademisë, kurse
- 6 trajnime jashtë kampusit të Akademisë, (por të cilat i janë nënshtruar procesit të testimit dhe vlerësimit nga Akademia, përfshirë edhe certifikimin e vijuesve).

**Të gjeturat** programet trajnuese të fushës së trajnimeve themelore-bazike janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e ISP-ve respektive.

- Vlerësimi i mësimnxënijes ka arritur një mesatare të nivelit të kënaqshmërisë prej 87.35 % ose 4.37 notë mesatare e regjistruar tek pothuajse të gjitha trajnimet përjashtimisht *Trajnimet bazik të hetimeve të krimin* i realizuar jashtë kampusit të Akademisë, me vlerësim 32.00% nivel të kënaqshmërisë ose 1.6 notë mesatare, e cila në kuadër të rekomandimeve tona ka rezultuar si jo i suksesshëm.
- Pjesa praktike e trajnimeve bazike nga totali i trajnimeve të realizuara, vetëm 20 trajnime kanë pjesën praktike sipas kurrikulës së programit trajnues. Nga vlerësimet e pranuar kemi regjistruar 94.10% nivel të kënaqshmërisë ose 4.27 notë mesatare. Vlen të ceket se përkundër vlerësimit të lartë, pjesa e komenteve ka sugjeruar që Akademia të rrisë nivelin e infrastrukturës ndihmëse për zhvillimin e pjesës praktike përkundër faktit që janë përdorur edhe infrastrukturat e ISP-ve respektive. Pjesa infrastrukturore dhe ato përcjellëse për zhvillimin e pjesës praktike kanë qenë të nivelit të kënaqshëm përkundër faktit që disa kanë kaluar afatin e amortizimit; sikurse ato të sallës së edukatës fizike dhe pjesa e poligonit të jashtëm të qitjes i cili nuk ka mungesa infrastrukturore përcjellëse duke nënvizuar edhe nevojën për rrethojat e poligonit të vozitjes përmes të cilave do bëhej ndarja nga pjesa e parkingut të kampusit.
- Materiali mësimor është vlerësuar me vlerësim prej 87.79% të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.30 me notë mesatare. Nga vlerësimet e pranuar dhe analizimi i materialeve kurrikulare –pasqyra e trajnimeve-DSC ka gjetur se jo të gjitha materialet janë të azhurnuara në kohë dhe të hartuara në përputhje me kërkesat për zhvillimin e trajnimeve në kategori sipas taksonomisë së Bloomit. Shpërndarja e materialeve në disa trajnime ka qenë e mangët dhe jo në kohë, posaçërisht trajnimet e zhvilluara jashtë kampusit të Akademisë, si *Trajnimet bazik të hetimeve të krimin* me vlerësim prej 44.00% të nivelit të kënaqshmërisë ose 2.20 nota mesatare, e cila edhe njëherë e konfirmon nevojën

për planifikim të mirëfilltë të trajnimit me elementet përcjellëse të saja në kuadër të kampusit të Akademisë.

- Prezantimi i Instruktorit/ligjëruesit është shënuar një punë dhe njohje e angazhimit të stafit mësimdhënës/instruktor në kuadër të Akademisë si një e arritur që gjithnjë ka tejkaluar të priturat. Kemi një arritshmërisë prej 90.00% të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.5 notën mesatare duke theksuar dhe adresuar edhe njohje me emra të përveqshëm të instruktorëve të angazhuar në ligjërime.
- Mjetet lehtësuese dhe mbështetëse vlerësimi i përgjithshëm ka qenë 83.96% niveli i kënaqshmërisë ose 4.19 nota mesatare dhe kjo si rrjedhojë e vlerësimeve të trajnimeve jashtë kampusit të Akademisë të cilat janë vlerësuar me mesatare prej 30.00% të nivelit të kënaqshmërisë ose 1.5 notë mesatare që edhe njëherë janë tregues për nevojën imediate të realizimit të trajnimit në kampusin e Akademisë meqë mjetet lehtësuese që posedon janë më të përshtatshme dhe në dispozicion për trajnerin dhe zyrtarët e trajnuar.
- Shërbimet e ofruara gjatë trajnimit janë të vlerësuara si të kënaqshme ose shprehur me nivel të kënaqshmërisë prej 90.00% , ose 4.5 notë mesatare e cila tregon se Akademia i kushton vëmendje edhe shërbimeve që ofron në kuadër të trajnimeve që realizohen në kampus dhe jashtë saj. Shërbimet e ofruara janë vlerësuar edhe në kuadër të komenteve e posaçërisht rëndësi të madhe i kushtohet respektimit të ligjit për gjuhët zyrtare ku Akademia ka ofruar shërbimet e përkthimit në të gjitha trajnimet dhe format e kërkuara për të cilat është pranuar një vlerësim i lartë.

**Të gjeturat e përgjithshme**, vlen të ceket se si pasojë e mos planifikimit racional të ISP-ve në kërkesat e tyre për trajnim, ka rezultuar edhe mospërfillja dhe shkurtim i trajnimeve të planifikuara gjerë në implementim të disa trajnimeve jashtë kampusit të Akademisë. Trajnimet e zhvilluara në kuadër të kampusit kanë arrit një mesatare të kënaqshme vlerësuese me disa rekomandime për përmirësim sidomos në fushën e implementimit të taksonomisë së Bloom-it e cila kërkon rishikim të trajnimeve. Në anën tjetër trajnimet e zhvilluara jashtë kampusit të Akademisë sipas raporteve vlerësuese, kanë dëshmuar se ISP-të nuk i plotësojnë kushtet për zhvillimin e trajnimeve meqë sipas komenteve të pjesëmarrësve janë evidentuar mungesa nga përgatitorë e implementuese gjerë tek infrastruktura e dedikuar për trajnim.

**Rekomandim**: plani i ANT-së për trajnime të jetë i koordinuar me Akademinë dhe racionalizimi i implementimit të trajnimeve të jetë konform mundësive që Akademia ofron në përputhje me nevojat e të gjitha ISP-ve respektive. Trajnimet e planifikuara të mbahen në kampusin e Akademisë meqë është i vetmi institucion që plotëson kushtet e zhvillimit të trajnimeve në fjalë. Po ashtu rekomandojmë që të krijohet një politikë për sqarimin e trajnimeve gjegjësisht procesin e rishikimit të trajnimeve bazuar në taksonominë e Bloomit sipas foljeve vepruese në kuadër të

nivelit të kualifikimeve me çka definojnë qartë se cilat folje duhet përdorur për llojin e trajnimeve themelore-bazike. Të krijohet politikë sistematike e rishikimit të materialeve trajnuese duke i azhurnuar dhe harmonizuar në përmbajtje. Ajo çka DSC ka regjistruar është se mungojnë të dhënat në web-faqe të Akademisë rreth trajnimeve të cilat përkundër një angazhimi të jashtëzakonshëm që ndodh në kampus, nuk pasqyrohet as edhe një informatë e vetme për to.




## Trajnimet e Avancuara

Kjo kategori e trajnimit ndryshe nga ato bazike-themelore, paraqet procesin e përvetësimit të njohurive në shkallë të avancuar në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike që në fushën e tyre do të jenë në gjendje të punojnë pa mbikëqyrje ose mbikëqyrje të kufizuar.

TRAJNIMET E AVANCUARA					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuar	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi Ngasja Emergjente	24	210	3-5 ditë	89.28%	4.44
Trajnimi Ngasja Emergjente me Mjete të Blinduara	1	04	5 ditë	99.00%	4.95
Trajnimi Hetimi i Dhunës Familjare	1	18	4 ditë	78.56%	3.93
Trajnimi Ndhima e Parë	2	21	10 ditë	70.08%	3.50
Heckler dhe Koch MP-5	1	12	5 ditë	91.70%	4.59
Trajnimi për Mbrojtje të Afërt	1	25	59 ditë	91.60%	4.58
Kursi Krijimi i Ekipes dhe Menaxhimi i Konflikteve	1	14	4 ditë	92.86%	4.64
Trajnimi i Avancuar i Teknikave Analitike	1	13	5 ditë	89.70%	4.49
Menaxhimi i Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë - Niveli i Parë	1	14	4 ditë	96.29%	4.61
Menaxhimi i Vijës së Mesme	1	15	30 ditë	97.00%	4.85
<b>Trajnimet e avancuara të realizuara jashtë kampusit të Akademisë</b>					
Heckler dhe Koch MP-5 (SHKK)	3	37	5 ditë	96.96%	4.80

Zbërthimi i trajnimeve të avancuara si në vijim:

- 37 trajnime të avancuara,
- 383 vijues në total,
- 90.28% mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.51 nota mesatare.



Nga totali i 26 trajnimeve të avancuara të vlerësuara:

- 34 trajnime janë mbajtur në kampusin e Akademisë, kurse
- 3 trajnime jashtë kampusit të Akademisë, (por të cilat i janë nënshtruar procesit të testimit dhe vlerësimit nga Akademia, përfshirë edhe certifikimin e vijuesve).

**Të gjeturat** programet trajnuese të fushës së trajnimeve të avancuara janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e ISP-ve respektive.

- Vlerësimi i mësimnxënijes ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 90.49 % ose 4.52 notë mesatare e regjistruar tek pothuajse të gjitha trajnimet përfshirë edhe trajnimet jashtë kampusit të Akademisë.
- Pjesa praktike e trajnimeve të avancuar nga totali i trajnimeve të realizuara, 31 trajnime kanë pjesën praktike sipas kurrikulës së programit trajnues. Nga vlerësimet e pranuar kemi regjistruar 89.25% nivel të kënaqshmërisë ose 4.46 notë mestarë. Vlen të ceket se përkundër vlerësimit të lartë, pjesa e komenteve ka sugjeruar që Akademia të rrisë nivelin e infrastrukturës ndihmëse sidomos mungesa për pajisje shtesë në sallat sportive dhe ato të palestrës së ushtrimeve fizike. Pjesa infrastrukturore dhe ato përcjellëse për zhvillimin e pjesës praktike kanë qenë të nivelit të kënaqshëm përkundër faktit që disa kanë kaluar afatin e amortizimit; sikurse ato të sallës së edukatës fizike dhe pjesa e poligonit të jashtëm të qitjes i cili nuk ka mungesa infrastrukturore përcjellëse duke nënvizuar edhe nevojën për rrethojat e poligonit të vozitjes përmes të cilave do bëhej nga pjesa e parkingut të kampusit, si dhe mungesa e kohëpaskohshme e qasjes në veturën për rrëshqitje në kuadër të trajnimeve nga fusha e trafikut.
- Materiali mësimor është vlerësuar me vlerësim prej 88.75% të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.22 me notë mesatare. Nga vlerësimet e pranuar dhe analizimi i materialeve kurrikulare –pasqyra e trajnimeve-DSC ka gjetur se jo të gjitha materialet janë të azhurnuara në kohë dhe të hartuara në përputhje me kërkesat për zhvillimin e trajnimeve në kategori sipas taksonomisë së Bloomit. Shpërndarja e materialeve në disa trajnime ka qenë në kohë, kurse azhurnimi i materialit ka qenë pjesë e komenteve në 50% të trajnimeve të vlerësuara.
- Prezantimi i Instruktorit/ligjëruesit kemi një arritshmërisë prej 92.52% të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.57 notën mesatare duke theksuar dhe adresuar edhe njohje me emra të përveqshëm të instruktorëve të angazhuar në ligjërime. Të gjitha komentet kanë qenë frymëzuese dhe falënderuese për punën e instruktorëve të cilët në raporte vlerësuese janë ofruar si rekomandim për njohjen e punës së tyre dhe si një mekanizëm shtesë për vlerësim, përjashtimisht trajnimit “Ndihma e parë” e cila është vlerësuar nën mesataren e trajnimeve të avancuara.
- Mjetet lehtësuese dhe mbështetëse vlerësimi i përgjithshëm ka qenë 88.28% niveli i kënaqshmërisë ose 4.41 nota mesatare e cila tregon përkushtimin e akademisë në ofrimin e mbështetjes në zhvillimin dhe realizimin e trajnimeve dhe nevojave të ISP-ve. Përkundër vlerësimit të lartë të pranuar, pjesa e

komenteve ka sugjeruar që Akademia të pasurohet me mjete lehtësuese në aspektin praktik të zhvillimit të trajnimit.

- Shërbimet e ofruara gjatë trajnimit janë të vlerësuara si të kënaqshme ose shprehur me nivel të kënaqshmërisë prej 93.92% , ose 4.70 notë mesatare e cila tregon se Akademia i kushton vëmendje edhe shërbimeve që ofron në kuadër të trajnimeve që realizohen në kampus dhe jashtë saj. Shërbimet e ofruara janë vlerësuar edhe në kuadër të komenteve e posaçërisht rëndësi të madhe i kushtohet logjistikës, e cila përkundër vlerësimit të lartë të pranuar, kërkohet vëmendje në materialet shpenzuese të ofruara gjatë trajnimit, të cilat në disa raste janë komentuar si të mangëta në sasi.

Trajnimet e zhvilluara në kuadër të kampusit kanë arrit një mesatare të kënaqshme vlerësuese me disa rekomandime për përmirësim sidomos në fushën e implementimit të taksonomisë së Bloom-it e cila kërkon rishikim të trajnimeve përfshirë edhe infrastrukturën trajnuese të kampusit të Akademisë. Mungesat në aspektin praktik dhe kushteve përcjellëse për trajnimet me armë zjarri dhe atyre të trafikut.

**Rekomandim:** plani i ANT-së për trajnime të avancuara të jetë i koordinuar me Akademinë përfshirë identifikimin e atyre trajnimeve të cilat janë mandatorë për avancimin profesional të zyrtarëve të ISP-së sipas planit paraprak dhe nevojave të identifikuara nga vitit paraprak. Trajnimet e planifikuara të mbahen në kampusin e Akademisë me kusht që Akademia të rrisë nivelin e pjesëve ndihmëse infrastrukture për zhvillimin e trajnimeve në aspektin praktik si poligonet e armëve të zjarrit, poligoni i vozitjes dhe pjesët tjera si laborator, dhoma simulative etj. Po ashtu rekomandojmë që të bëhet rishikimi i trajnimeve bazuar në taksonominë e Bloomit e cila duhet harmonizuar edhe me materialet prezantuese të instruktorëve/ligjëruesve në trajnim.

## Trajnimet e Specializuara

Kjo kategori e trajnimit, ndryshe nga ato në bazike-themelore dhe të avancuara, paraqet procesin e përvetësimit të njohurive në shkallën më të lartë në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike, të cilët në fushën e tyre do të jenë në gjendje të punojnë në mënyrë të pavarur duke ofruar këshilla dhe opinione profesionale në fushën e sigurisë publike. Për vitin 2022, përkundër planifikimeve fillestare gjatë vitit 2022 është zhvilluar vetëm një trajnim i kësaj kategorie.

TRAJNIMET E SPECIALIZUAR					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuar	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi i avancuar në taktikat mbrojtëse	1	39	20 ditë	96.77%	4.84

**Të gjeturat** programi trajnues i fushës së trajnimeve të specializuara është adresuar në raportin e përveqshëm.

**Rekomandim:** plani i ANT-së për trajnime të specializuara të jetë i planifikuar mirë në implementim duke krijuar mundësitë e zhvillimit të tyre, meqë janë trajnime që plotësojnë kompetencën në fushën e kërkuar. Po ashtu rekomandojmë që të bëhet rishikimi i trajnimeve bazuar në taksonominë e Bloomit e cila duhet harmonizuar edhe me materialet prezantuese të instruktorëve/ligjëruesve në trajnim.


## Trajnime për Instruktor

Kjo kategori e trajnimit, paraqet një fushë të përgatitjes së kuadrove të reja të instruktorëve /ligjëruesve në fushën e trajnimeve në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike, të cilët do të jenë në gjendje të punojnë në cilësinë e instruktorit.

TRAJNIMET PËR INSTRUKTOR					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuar	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Programi për Aftësimin e Instruktorëve	3	39	20 ditë	96.55%	4.83

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 3 trajnime për zhvillimin e instruktorëve,
- 39 vijues në total,
- 96.55% mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.85 nota mesatare.



**Të gjeturat** programet trajnuese të fushës së trajnimeve të avancuara janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e ISP-ve respektive.

- Vlerësimi i mësimnxënies ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 94.46 % ose 4.62 notë mesatare e regjistruar tek pothuajse të gjitha trajnimet përfshirë edhe trajnimet jashtë kampusit të Akademisë.
- Pjesa praktike e trajnimeve për instruktor është objekt vlerësimi i instruktorëve të dedikuar për vlerësimin e paraqitjes së pjesëmarrësve në trajnim andaj edhe nuk vlerësohen nga DSC.
- Materiali mësimor është vlerësuar me vlerësim prej 92.83% të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.54 me notë mesatare. Nga vlerësimet e pranuar dhe analizimi i materialeve kurrikulare –pasqyra e trajnimeve-DSC ka gjetur se materialet kërkojnë azhurnim me informacione të reja. Shpërndarja e materialeve në disa trajnime ka qenë në kohë.
- Prezantimi i Instruktorit/ligjëruesit kemi një arritshmërisë prej 96.70% të nivelit të kënaqshmërisë ose

4.70 notën mesatare duke theksuar dhe adresuar edhe njohje me emra të përveqshëm të instruktorëve të angazhuar në ligjërime.

- Mjetet lehtësuese dhe mbështetëse vlerësimi i përgjithshëm ka qenë 91.58% niveli i kënaqshmërisë ose 4.48 nota mesatare e cila tregon përkushtimin e akademisë në ofrimin e mbështetjes në zhvillimin dhe realizmin e trajnimeve dhe nevojave të ISP-ve.
- Shërbimet e ofruara gjatë trajnimit janë të vlerësuara si të kënaqshme ose shprehur me nivel të kënaqshmërisë prej 93.11% , ose 4.55 notë mesatare e cila tregon se Akademia i kushton vëmendje edhe shërbimeve që ofron në kuadër të trajnimeve që realizohen në kampus dhe jashtë saj.

Trajnimet e zhvilluara në kuadër të kampusit kanë arrit një mesatare të kënaqshme vlerësuese me disa rekomandime për përmirësim sidomos në fushën e implementimit të taksonomisë së Bloom-it e cila kërkon rishikim të trajnimeve përfshirë edhe infrastrukturën trajnuese të kampusit të Akademisë.

**Rekomandim:** trajnimet për instruktor në kuadër të programit kanë edhe pjesën e ricertifikimi të instruktorëve të cilat jo gjithnjë zbatohen në afatet e përcaktuara nga programi për instruktor. Rekomandojmë rritjen e numrit të trajnimeve për trajner si nevojë e ISP-ve respektive nga fushat e identifikuar sipas ANT-së. Po ashtu rekomandojmë që të bëhet rishikimi i trajnimeve bazuar në taksonominë e Bloomit e cila duhet harmonizuar edhe me materialet prezantuese të instruktorëve/ligjëruesve në trajnim.

## Të gjeturat sipas trajnimeve për ISP

Në vazhdim kemi paraqitur trajnimet të cilat janë realizuar në Akademi për ISP-të Janar - Dhjetor 2022. Përkundër numrit të lartë të trajnimeve të planifikuara për vitin 2022 janë realizuar vetëm 71 trajnime për ISP-të, objekt i vlerësimit kanë qenë trajnimet të cilat janë të tipit trajnim me test e që nënkupton certifikimin apo matjet e arritshmërisë së kompetencës e të cilat janë objekt i yni vlerësues. Procesi i certifikimit të pjesëmarrës në kuadër të trajnimeve kalon përmes testimit me standardin minimal 70% të përgjigjeve të sakta. Trajnimet e tipit ricertifikues dhe të atyre të mbyllura përkundër realizimit në Akademi, nuk vlerësohen nga DSC, bazuar në kërkesat e njësive në përputhje me politikat trajnuese në Akademi.

Plani i trajnimeve për ISP	Planifikuara		Realizuara	
	trajnime	vijues	trajnime	vijues
Policia e Kosovës	41	973	50	1074
Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave	14	308	9	149
Inspektorati Policor i Kosovës	7	110	0	0
Shërbimi Korrektues i Kosovës	25	415	10	167
Shërbimi Sprovues i Kosovës	6	150	0	0
Dogana e Kosovës	12	240	3	43

### Policia e Kosovës

Për vitin 2022 janë planifikuar 41 trajnime me gjithsejtë 973 pjesëmarrës, kurse janë realizuar 50 trajnime me 1074 pjesëmarrës ose ka tejkaluar realizimin e planifikuar për 21%, me një vlerësim mesatar prej 86.15% të nivelit të kënaqshmërisë ose me një notë mesatare prej 4.30.


POLICIA E KOSOVËS					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
<b>Trajnimet nga fusha e trafikut</b>					
Trajnimi Ngasja Emergjente	24	210	3-5 ditë	89.28%	4.44
Trajnimi Ngasja Emergjente me Mjete të Blinduara	1	4	5 ditë	99.00%	4.95
Trajnimi Aksidentet e Komunikacionit Rrugor	1	20	5 ditë	98.00%	4.90
<b>Trajnimet nga fusha e hetimeve</b>					
Trajnimi Themelor i Hetimeve të Krimit	2	53	19 ditë	72.18%	3.62
Trajnimi Hetimi i Dhunës Familjare	1	18	4 ditë	78.56%	3.93
<b>Trajnimet nga fusha e përgjithshme e policisë</b>					
Trajnimi Ndhima e Parë	1	9	10 ditë	70.08%	3.50

Kursi i Policisë në Bashkësi	1	13	10 ditë	72.77%	3.66
Trajnimi profesional "Zyrtar Policor"	1	448	165 ditë	71.68%	3.59
<b>Trajnimet nga fusha e armëve të zjarrit</b>					
Heckler dhe Koch MP-5	1	12	5 ditë	91.70%	4.58
Ricertifikimi i Kursit për Instruktor të Armëve të Zjarrit	1	10	1 ditë	<i>Kurset/trajnimet e ricertifikimit nuk i nënshtrohen fazës testuese andaj edhe nuk vlerësohen</i>	
<b>Trajnimet nga fusha e njësive të specializuara</b>					
Trajnimi për Njësinë Speciale Intervenuese	1	15	60 ditë	97.00%	4.85
Trajnimi për Mbrojtje të Afërt	1	25	59 ditë	91.60%	4.58
<b>Trajnimet nga fusha e standardeve</b>					
Programi për Aftësimin e Instruktorëve	2	23	20 ditë	96.55%	4.83
Kursi Krijimi i Ekipes dhe Menaxhimi i Konfliktëve	1	14	4 ditë	92.86%	4.64
<b>Trajnimet nga fusha e policisë kufitare</b>					
Trajnimi Bazik i Policisë Kufitare - Frontex	1	20	19 ditë	89.53%	4.48
<b>Trajnimet nga fusha e taktikave mbrojtëse dhe aftësive fizike</b>					
Kursi i Ricertifikimit	3	68	3 ditë	<i>Kurset/trajnimet e ricertifikimit nuk i nënshtrohen fazës testuese andaj edhe nuk vlerësohen</i>	
<b>Trajnimet e ofruara nga UNDP për Policinë e Kosovës</b>					
Trajnimi për Detektimin e Armëve, Municion dhe Eksplozivëve që Trafikohen Përmes Postës së Shpejtë dhe Dërgesave Postare	2	29	2 ditë	<i>Kurset/trajnimet te cilat nuk i nënshtrohen fazës testuese nuk janë objekt vlerësimi</i>	
<b>Trajnimet e ofruara nga BE për Policinë e Kosovës</b>					
Trajnimi Prezentim i PDI-së për Analistë	2	24	5 ditë	89.70%	4.49
Trajnimi i Avancuar i Teknikave Analitike	1	13	5 ditë	89.70%	4.49

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 50 trajnime në total (46 trajnime të realizuara në kampus dhe 4 trajnime jashtë kampusit të Akademisë),
- 1008 vijues në total,
- 86.15 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.30 nota mesatare.





Trajnimet për Policinë e Kosovës sipas fushave të përcaktuara në kuadër të Planit të Trajnimeve për vitin 2022.

**Të gjeturat:** programet trajnuese për Policinë e Kosovës janë zhvilluar dhe implementuar sipas kërkesës së policisë përfshirë edhe mbështetjen e trajnimeve jashtë kampusit të Akademisë. Nga totali vlerësimeve neve kemi këto të gjetura si në vijim:

**Trajnimet nga fusha e trafikut** përbejnë pjesën dërmuese të trajnimeve të realizuara në Akademi për Policinë e Kosovës ose 50% të gjitha trajnimeve dhe nëse i shtojmë edhe modulën e trajnimit profesional del që gjysma e trajnimeve janë ofruar nga fusha e trafikut. Mesatarja e kënaqshmërisë është 94.14%, me një notë mesatare prej 4.69 me gjithsejtë 214 vijues në trajnimet e trafikut (*nëse i shtojmë modulën e trafikut në trajnimin profesional prej 447 kadetëve*), kemi në total 661 vijues në total në fushën e trafikut.

Trajnimet e zhvilluara të trafikut janë kryesisht trajnime të shkurtra dhe të cilat në vetë ngërthejnë kryesisht pjesën praktike. Përdorimi i poligonit të vozitjes në kampus është esencial për zhvillimin e trajnimeve të kësaj fushe. Në kuadër të komenteve është regjistruar nevoja për vendosjen e rrethojave të poligonit të vozitjes duke e bërë ndarjen me pjesën e dedikuar për parking të automjeteve në kampus. Të gjitha fushat e vlerësuara kanë një vlerësim që tejkalojnë të priturat andaj kërkohet vazhdimësi e rezultateve të arritura fal punës së instruktorëve të trafikut.

**Rekomandim:** të bëhet rishikim periodik i trajnimeve nga fusha e trafikut duke përdorur taksonominë e Bloomit. Të planifikohet ndarja fizike e poligonit të vozitjes nga parkingu i automjeteve si dhe të pasurohen e të mirëmbahen pajisjet trajnuese si vetura rrëshqitëse. Në anën tjetër të planifikohet mundësia e avancimit të mjeteve të përdorura në trajnimet e trafikut duke funksionalizuar qytezën simulative në kampus.

**Trajnimet nga fusha e hetimeve** përbejnë 6% të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 75.35% ose 3.77 notë mesatare. Vlerësimet e pranuar kanë treguar nevojën për rishikim të materialeve trajnuese dhe të materialit mësimor në menaxhim dhe shpërndarje. Vlerësimi më i lartë është arrit për instruktorët ligjërues ose 79.46% të nivelit të kënaqshmërisë ose 3.59 notë mesatare. Sa i përket trajnimeve nga fusha e hetimit të zhvilluara jashtë kampusit të Akademisë në hapësirat improvizuese, vlerësimi i pranuar është shumë i ulët nën mesataren e pranuar ose 41.28% nivel të kënaqshmërisë me notë mesatare prej 2.13 e cila njëherësh shënon edhe vlerësimin më të ulët të pranuar ndonjëherë në vlerësim.

**Rekomandim:** trajnimet e planifikuara të mbahen në kampusin e Akademisë meqë është i vetmi institucion që plotëson kushtet e zhvillimit të trajnimeve në fjalë me të gjitha elementet përbërëse të saj. Të bëhet rishikimi i trajnimeve konform taksonomisë së Bloomit. Po ashtu rekomandojmë që akademia në kuadër të kampusit të saj të rrisë nivelin e mjeteve lehtësuese dhe mbështetëse për zhvillimin e trajnimeve nga fusha e hetimeve duke avancuar dhomën simulative për zhvillimin e skenarëve të hetimit.

**Trajnimet nga fusha e përgjithshme e policisë** përbejnë 6% të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 71.51% ose 3.58 notë mesatare. Vlerësimet e pranuar kanë treguar nevojën për rishikim të materialeve trajnuese sidomos tek trajnimi i ndihmës së parë si dhe të materialit mësimor në menaxhim dhe shpërndarje. Vlen të ceket që në kuadër të trajnimeve nga fusha e përgjithshme e policisë bën pjesë edhe “Trajnimi Profesional – Zyrtar Policor” me gjithsejtë 447 kadetë për një periudhë kohore prej 7 muajsh sipas vendimit të KD të AKK mbi akreditimin e Akademisë si IAAP me trajnim të validuar. Andaj ngarkesa e stafit të përcaktuar në trajnimet e përgjithshme përkundër përqindje së vogël në trajnime prej 6%, angazhimi i tyre në kohëzgjatje është 58.3% përgjatë tërë vitit 2022 vetëm me trajnimin profesional.

**Rekomandim:** të bëhet rishikim periodik i trajnimeve nga fusha e përgjithshme duke përdorur taksonominë e Bloomit. Nga ky rekomandim përjashtohet “Trajnimi profesional – Zyrtar Policor” i cili ka të vendosur taksonominë e Bloomit në përputhje me mësimnxënijen dhe nivelin e kërkuar sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Të pasurohet kampusi me pajisje shtesë për zhvillimin e trajnimeve të përgjithshme, theks të veçante mbështetja logjistike, shërbimet mbështetëse të ofruara gjatë zhvillimit të trajnimit të cilat në kuadër të komenteve të pranuar kanë rezultuar që nuk janë të mjaftueshme për numrin e vijuesve në trajnim.

**Trajnimet nga fusha e armëve të zjarrit** përbejnë 6% të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 91.67% ose 4.56 notë mesatare. Po ashtu vlen të theksohet se instruktorët e armëve të zjarrit kanë qenë në formë intensive të angazhuar edhe në trajnimet profesionale në modulën e armëve të zjarrit ose në kuadër të moduleve tjera apo rutinave të parapara në kuadër të trajnimeve profesionale të zhvilluara në kampus gjatë vitit 2022.

**Rekomandim:** Pjesa infrastrukturore dhe ato përcjellëse për zhvillimin e pjesës praktike kanë qenë thelbi kryesor i komenteve dhe sugjerimeve për përmirësim, sidomos pjesa e poligonit të jashtëm të qitjes i cili nuk ka mungesa infrastrukturore përcjellëse dhe nuk plotëson standardet e kërkuara për zhvillimin e trajnimeve me armë zjarri.

**Trajnimet nga fusha e njësive të specializuara** përbejnë 6% të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 97.30% ose 4.71 notë mesatare.

**Rekomandim:** Pjesa përcjellëse infrastrukturore ka qenë pika kyçe e sugjerimeve rreth për përmirësim, sidomos dedikimi i një pjesë që ndërlidhet me ushtrimet dhe zhvillimin e programit trajnues.

**Trajnimet nga fusha e standardeve** përbejnë 5% të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 94.70% ose 4.73 notë mesatare.

**Rekomandim:** bazuar në të gjeturat tona dhe shqyrtimit të pjesës së pasqyrës së programit po ashtu shprehet nevoja për implementimin e taksonomisë së Bloomit, harmonizimin e materialit trajnues, prezantimeve të instruktorëve dhe doracakut të pjesëmarrësve.

**Trajnimet nga fusha e policisë kufitare** përbejnë 4% të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 89.53% ose 4.48 notë mesatare.

**Rekomandim:** ky trajnim nuk është i kategorizuar si duhet dhe mungon periudha e rishikimit andaj rekomandojmë një plan të veprimit për rishikim të materialit sipas taksonomisë së Bloomit. Në kuadër të komenteve kemi pranuar njohje për punën e instruktorëve nevojën për mbështetje me materiale trajnuese në zhvillimin e trajnimit.

**Trajnimet nga fusha e taktikave mbrojtëse dhe aftësive fizike** përbejnë 7% të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë dhe të cilat i takojnë trajnimeve që ofrojnë testim andaj edhe nuk janë objekt i vlerësimit nga Akademia. Pjesa dërmuese e ricertifikimeve bazuar në kapacitete njerëzore trajnuese të zhvilluara nga Akademia, tashmë mbahen në regjionet e caktuara policore meqë i takojnë trajnimeve që ofrohen gjatë shërbimit.

**Rekomandim:** trajnimet nga fusha e taktikave mbrojtëse ndërlidhen me sallat sportive dhe pajisjet përcjellëse nga fusha e edukatës fizike. Nga vlerësimi ynë Akademia duhet urgjentisht të investoj në mirembajtjen e pajisjeve në sallat sportive dhe palestër sportive sa më parë të jetë e mundur.

**Trajnimet e ofruara nga UNDP dhe BE** përbejnë 10% të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 89.70% ose 4.49 notë mesatare. Trajnimet e ofruara nga UNDP po ashtu nuk kanë rezultuar me testim meqë nuk ofrojnë kompetencë andaj edhe si të tilla nuk janë objekt vlerësimi i Akademisë.

**Rekomandim:** edhe këto trajnime mungojnë në aspektin e klasifikimit klasik që ofrohet në Akademi dhe po ashtu rishikimi i trajnimeve sipas taksonomisë së Bloomit për nivelin e dedikuar.

## Shërbimi Korrektues i Kosovës

Për vitin 2022 janë planifikuar 25 trajnime me gjithsejtë 415 pjesëmarrës, kurse janë realizuar 10 trajnime me 167 pjesëmarrës ose ka realizuar 40% të trajnimeve të planifikuara me një vlerësim të lartë prej 94.66% të nivelit të kënaqshmërisë ose me një notë mesatare prej 4.68.

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Menaxhimi i Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë - Niveli i Parë	1	14	4 ditë	96.29%	4.61
Trajnimi Profesional “Zyrtar Korrektues”	1	48	165 ditë	92.73%	4.64
Trajnimi i Avancuar në taktikat mbrojtëse për SHKK	1	15	5 ditë	96.78%	4.84
Trajnimi Intervista Motivuese	1	11	3 ditë	92.86%	4.64
<b>Trajnimet bazike të realizuara jashtë kampusit të Akademisë</b>					
Heckler dhe Koch MP-5	3	37	5 ditë	96.96%	4.80
Trajnimi Themelor për Pistoletën Glock 9x19 (SHKK)	3	37	5 ditë	94.05%	4.63

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 10 trajnime në total (4 trajnime të realizuara në kampus dhe 6 trajnime jashtë kampusit të Akademisë),
- 167 vijues në total,
- 94.95 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.69 nota mesatare.

Në kuadër të trajnimeve për Shërbimin Korrektues të Kosovës është realizuar edhe trajnimi profesional “zyrtar korrektues” me gjithsejtë 48 kadetë kadetë për një periudhë kohore prej 7 muajsh sipas vendimit të KD të AKK mbi akreditimin e Akademisë si IAAP me trajnim të validuar. Andaj ngarkesa e stafit ka qenë e koncentruar në trajnimin profesional.

Vlerësimet e pranuar kanë treguar nevojën për rishikim të materialeve trajnuese dhe të materialit mësimor në menaxhim dhe shpërndarje.

**Të gjeturat;** DSC ka vlerësuar edhe pasqyrat e trajnimeve dhe ka gjetur se mungon taksonomia e Bloomit (perjashtimisht trajnimin profesional), trajnimet tjera duhet rishikuar në formë sistematike.

**Rekomandim:** plani i ANT-së për trajnimin profesional të jetë i koordinuar me Akademinë dhe në rivalidimin e radhës së trajnimit profesional të rishikohet programi pjesët e identifikuara si nevojë për ndryshim. Po ashtu rekomandojmë që të digjitalizohet sistemi i të dhënave dhe listave

në SHKK duke i ofruar Akademisë informatë më të shpejtë rreth kadetëve dhe përmbushjes së obligimeve ndaj AKK si deklarimi i stafit dhe i pjesëmarrësve në trajnim, e cila për këtë gjeneratë ka qenë pak e vonuar. Trajnimet tjera të deklaruara në kuadër të planit vjetor të trajnimeve të jete trajnime të realizuara dhe të mos kemi perseritje në mos-realizimin e trajnimeve dhe planit të ANT-se. Trajnimet e realizuara jashtë kampusit të Akademisë janë trajnime me realizim të lartë për kundra faktit që preferohet që të bëhet ndaraj në mes të trajnimeve me kompetencë dhe atyre gjatë shërbimit të cilat do mund të realizoheshin në ISP-të respektive.

### [Shërbimi Sprovues i Kosovës](#)

Për vitin 2022 janë planifikuar 6 trajnime me gjithsejtë 150 pjesëmarrës dhe nuk është realizuar asnjë nga trajnimet e planifikuara dhe të deklaruara në punotrin e planit vjetor të trajnimeve në Akademi.

**Të gjeturat:** mungesë në planifikim të trajnimeve dhe të nevojave për trajnim në kuadër të institucionit sprovues.

**Rekomandim:** trajnimet e deklaruara në kuadër të planit vjetor të trajnimeve të jete trajnime të realizuara dhe të mos kemi perseritje në mos-realizimin e trajnimeve dhe planit të ANT-se.

## Dogana e Kosovës

Për vitin 2022 janë planifikuar 12 trajnime me gjithsejtë 240 pjesëmarrës dhe janë realizuar 3 trajnime me gjithsejtë 43 pjesëmarrës (keto trajnime kanë qenë trajnime të ricertifikimit – të cilat i takojnë trajnimeve që ofrohet gjatë shërbimit dhe nuk janë trajnime të kompetencës profesionale të testuar andaj edhe nuk i nënshtrohet vlerësimit).

DOGANA E KOSOVËS					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Ricertifikimi Kursi Bazik për Arrest dhe Ndalim	3	43	3 ditë	<i>Kurset/trajnimet e ricertifikimit nuk i nënshtrohen fazës testuese andaj edhe nuk vlerësohen</i>	

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 3 trajnime në total (te realizuara në kampus),
- 43 vijues në total,

**Te gjeturat:** mungese në planifikim të trajnimeve dhe të nevojave për trajnim në kuadër të institucionit doganor.

**Rekomandim:** trajnimet e deklaruara në kuadër të planit vjetor të trajnimeve të jete trajnime të realizuara, si dhe të bëhet ndarja e trajnimeve me kompetencë dhe trajnimeve që ofrohen gjatë shërbimit të cilat do mund të zhvilloheshin në kuadër të ISP-ve respektive.

## Agjencia e Menaxhimit Emergjent

Per vitin 2022 jane planifikuar 14 trajnime me gjithsejt 308 pjesmarres, kurse jane realizuar 9 trajnime me gjithsejt 149 pjesmarres ose ka realizuar 64.29% te trajnimeve te planifikuara me nje mesatare te arritshmeri prej 96.02 % mesatarja e kënaqshmërisë ose 4.81 nota mesatare.

AGJENCIA PËR MENAXHIM TË EMERGJENCAVE					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi Bazik në Zjarrfikje dhe Shpëtim	3	59	9/10 ditë	94.47%	4.76
Kursi Vlerësimi i Rreziqeve	1	15	3 ditë	93.56%	4.68
Trajnimi Shuarja e Zjarreve Fushore dhe Malore	3	40	3 ditë	95.31%	4.77
Trajnimi Zjarret e Brendshme dhe Shuarja e Tyre	1	15	5 ditë	98.75%	4.94
Trajnimi Aksidentet e Komunikacionit Rrugor	1	20	5 ditë	98.00%	4.90

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 9 trajnime në total,
- 149 vijues në total,
- 96.02 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.81 nota mesatare.

**Të gjeturat:** mungese ne rishikimin sistematik te trajnimeve, mungese ne taksonomine e Bloomit. Po ashtu ka ngecje ne arritshmerine e implementimit te trajnimeve si pasoje e zhvillimit te trajnimeve profesionale.

**Rekomandim:** te behet rishikimi i trajnimeve meqe pasqyra trajnuese nuk perkon me nivelin dhe taksonomine e Bloomit. Te behet harmonzimi i ANT dhe mundesive te realizimit te trajnimeve. Akademia te investoj ne zhvillimin e hapësirave shtese trajnuese qe nderlidhen me zjarrfikje, sidomos ato qe nderlidhen edhe me realizimin e trajnimit profesional, e cila gjere me tani ne mungese te poligonit per zjarrfikje ka qene pothuajse i pamundur te realizohet. Hapësirat jane egzistuese – ajo ne Studime dhe ne Banje, mirepo mungon infrastruktura ndeihmese tranuese si kontenjeret dhe objektet percjelle ne perputhje me standardet e kerkuara per zhvillimin e pjeses praktike te trajnimeve me zjarrfikje.



Per vitin 2022 jane planfikuar te mbahen 7 trajnime me gjithsejt 110, kurse nuk eshte realizuar asnje nga trajnimet e planifikuara.

**Të gjeturat:** mungese ne planfikim te trajnimeve dhe te nevojave per trajnim ne kuader te institucionit sprovues.

**Rekomandim:** trajnimet e deklaruar ne kuader te planit vjetor te trajnimeve te jete trajnime te realizuara dhe te mos kemi perseritje në mos-realizimin e trajnimeve dhe planit te ANT-se.

## Të gjeturat sipas trajnimeve të ofruara nga Partnerët Ndërkombëtar

ICITAP					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi Laboratorët Klandestinë	1	35	10 ditë	94.86%	4.74
OSBE					
Trajnimi i Avancuar për Taktikat Mbrojtëse për SHKK	1	15	5 ditë	96.78%	4.84
Trajnim për Komunikimin në Krizë për Zyrtarët për Informim të Sektorit të Sigurisë	1	14	5 ditë	96.20%	4.71
Trajnimi për Mbikëqyrjen e Linjës së Parë për Zyrtarët e SHKK	1	28	5 ditë	81.6%	4.08
Trajnimi i Avansuar për Hetime Penale dhe Forenzikë	1	11	5 ditë	<i>Kurset/trajnimet te cilat nuk i nënshtrohen fazës testuese nuk janë objekt vlerësimi</i>	

### ICITAP

Për vitin 2022 ICITAP ka planifikuar të ofroj 4 trajnime me gjithsejt 90 pjesmarres, kurse ka realizuar vetem 1 trajnim me gjithsejt 35 pjesemarres ose ka realizuar 25.00% te trajnimeve te planifikuara dhe te deklaruar ne kuader te planit te trajnimeve per vitin 2022.

**Të gjeturat:** trajnimet qe planifikohet te ofrohen nga ICITAP jane trajnime te ofrohet për ISP dhe kryesisht jane trajnime me eksperte te fushes se ngushtë në përputhje me nevojat e ISP-ve.

**Rekomandim:** trajnimet të kategorizohen ne kuadër te kategorizimeve ne Akademi dhe te jene ne perputhje me taksonomine e Bloomit.

### OSBE

Për vitin 2022 OSBE ka planifikuar të ofroj 6 trajnime me gjithsejt 125 pjesmarres, kurse ka realizuar 4 trajnime me gjithsejt 68 pjesemarres ose ka realizuar 66.67% te trajnimeve te planifikuara dhe te deklaruar ne kuader te planit te trajnimeve per vitin 2022.

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 4 trajnime në total,
- 125 vijues në total,
- 91.53 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.54 nota mesatare.

**Të gjeturat:** trajnimet e ofruara nga OSBE jane trajnime te ofrohet per ISP dhe kryesisht trajnime me eksperte te fushes se ngushte. Bazuar ne pasqyrat e trajnimeve, DSC ka gjetur se mungon taksonomia e Bloomit.

**Rekomandim:** trajnimet te kategorizohen ne kuader te kategorizimeve ne Akademi dhe te jene ne perputhje me taksonomine e Bloomit.

## Trajnimet te ofruara nga Akademia

Per vitin 2022 Akademia ka planifikuar të ofroj 15 trajnime me gjithsejt 275 pjesmarres, kurse ka realizuar 9 trajnime me gjithsejt 185 pjesemarres ose ka realizuar 60.00% te trajnimeve te planifikuara dhe te deklaruar ne kuader te planit te trajnimeve per vitin 2022.

AKADEMIA					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Programi për Aftësimin e Instrukturëve	1	16	19 ditë	96.55%	4.83
Menaxhimi i Vijës së Parë	1	20	20 ditë	98.90%	4.95
Trajnimi Gjuha Angleze - Niveli Fillestar	1	11	10 ditë	97.45%	4.87
Trajnimi Elementet Bazë të Menaxhimit	2	41	5 ditë	97.80%	4.89
Trajnimi Ndihma e Parë	1	12	3 ditë	70.08%	3.50
Trajnim për Menaxhimin e Kontratave (në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik)	1	30	2 ditë	91.70%	4.58
Menaxhimi i Vijës së Mesme	1	15	30 ditë	97.00%	4.85
Menaxhimi i Kontratave përmes e-prokurimit (në bashkëpunim me IKAP)	1	40	2 ditë	94.47%	4.76

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 9 trajnime në total,
- 185 vijues në total,
- 92.99 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.65 nota mesatare.

**Të gjeturat:** perkunder planifikimeve per vitin 2022, Akademia ka realizuar 60% te trajnimeve te cilat i ka ofruar per ISP-te dhe stafin e Akademise si pjese e kerkesave te dala nga plani individual i trajnimeve per stafin e saj. Perkunder kerkesave te identifikuar dhe te deklaruar Akademia ka edhe nje plan shtese te zhvillimit te stafit te saj, te cilat nuk inkuadrohen ne kuader te planit vjetor te trajnimeve.

**Rekomandim:** te behet rishikimi i trajnimeve meqe pasqyra trajnuese nuk perkon me nivelin dhe taksonomine e Bloomit. Ne kuader te planit vjetor te trajnimeve te mos paraqiten trajnimet per zhvillimin e stafit te saj e cila i takon politikave te brendshme te Akademise. Kerkohet qe Akademia te ngrise nivelin e saj te zhvillimit te kurrikulave sipas nevojave te ISP-ve dhe te kaloj nga aspekti teknik ne ate zhvillimor, meqe posedon listen e eksertve e cila deri tash nuk eshte perdorur ne kapacitetin e saj te plote, perfshire edhe ate te burimeve njerezore qe posedon, e cila gjere me tani eshte vetem ne aspektin teknik. Akademia ne kuader te organogramit te saj ka Departamentin e trajnimeve dhe perkrahjes arsimore me divizionet perberese te saj nga fusha e trajnimeve sikurse ai i trajnimit, zhvillimit te kurrikulave, sherbimeve studentore dhe te perkthimit, mirepo niveli i angazhimit te saj ne zhvillim te kurrikulave dhe mbajtjes se trajnimeve mbetet i deshirueshem.

## Komentet e përmbledhura

Vijuesit në trajnimet e realizuara në Akademi dhe jashtë kampusit në pjesën e dedikuar për komente kanë shfaqur sinqeritet dhe kanë ofruar propozimet e tyre të cilat ndërlidhen me procesin dhe ngritjen e tyre profesionale në fushat e caktuara të sigurisë publike. Në përgjithësi kemi pranuar komente pozitive për gjithë procesin e trajnimeve, ushtrimeve dhe aktiviteteve në Akademi dhe po ashtu pjesëmarrësit/kadetët kanë vlerësuar gjithë procesin e zhvillimit të trajnimeve nga mesimnxenija, materiali mesimor, ligjeruesit/mesimdhënesit dhe instruktoret, shërbimet, logjistiken e shërbimet mbështetëse të ofruara në trajnim.

Ata kanë inkurajuar Akademin në investimin e fushës së trajnimeve sidomos në sistematizimin e trajnimeve në aspektin e rishikimit të materialeve trajnuese duke qëndruar në hap me ndryshimet e reja. Pjesëmarrësit kanë deklaruar mbi përkushtimin e mësimitdhënësve/instruktorëve në vazhdimin e përkushtimit dhe motivimit të tillë për pjesëmarrësit duke ofruar interaktivitet gjatë dhe duke vlerësuar çdo mendim. Në fakt pjesa e komenteve janë të gjeneralizuara në njohjen dhe paraqitjen profesionale të dëshmuar të mësimitdhënësve/instruktorëve në Akademi.

Mbetet ende e dëshiruar reflektimi i Akademisë në investimin e saj në rregullimin e disa fushave trajnuese si ajo e poligoneve apo edhe e mbështetjes logjistike në disa raste të evidentuara.

Në total kemi pranuar dhe analizuar 1542 komente.

## Rekomandimet e përmbledhura

Divizioni për sigurimin e cilësisë në Akademi, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e pjesemarrësve në trajnimet e realizuara përgjatë vitit 2022 dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të Akademisë që të merren hapat si më poshtë:

- Akademia në fazën e planifikimeve të trajnimeve profesionale të ri aranzhohet mundësia e fillimit të gjeneratave me numër më të vogël dhe të shpërndarë përgjatë vitit duke ofruar mundësinë e ndjekjes së moduleve në vazhdimësi.
- Trajnimet e planifikuara të mbahen në kampusin e Akademisë meqë është i vetmi institucion që plotëson kushtet e zhvillimit të trajnimeve në fjalë me të gjitha elementet përbërëse të saj.
- Akademia të arrijë ta bëjë shpërndarjen e kapaciteteve trajnuese duke ofruar një plan të balancuar të trajnimit me ISP-të tjera që ndjekin trajnim në Akademi;
- Të digjitalizohet sistemi i të dhënave dhe listave në trajnimet profesionale duke i ofruar Akademisë informatë më të shpejtë rreth kadetëve dhe përmbushjes së obligimeve ndaj AKK si deklarimi i stafit dhe i pjesëmarrësve në trajnim;
- Trajnimet gjatë rishikimit apo edhe zhvillimit të trajnimeve të reja të marrin për bazë implementimin e taksonomisë së Bloom-it sipas foljeve vepruese në kuadër të nivelit të kualifikimeve me çka definojnë qartë se cilat folje duhet përdorur për llojin e trajnimeve gjegjëse;
- Të krijohet politikë sistematike e rishikimit të materialeve trajnuese duke i azhurnuar dhe harmonizuar në përmbajtje;
- Të rritet numri i bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve me IAAP vendore dhe ndërkombëtare për të mundësuar mobilitet të kadetëve;
- Të pasqyrohen të gjitha aktivitetet në web-faqe, e cila në fushën e trajnimeve është e zbrazët;
- Akademia të rrisë nivelin e pjesëve ndihmëse infrastrukurore për zhvillimin e trajnimeve në aspektin praktik si poligonet e armëve të zjarrit, zjarrfikjes, poligoni i vozitjes dhe pjesët tjera si laboratorit, dhoma simulative, FATS.
- Të planifikohet mundësia e avancimit të mjeteve të përdorura në trajnimet e trafikut duke funksionalizuar qytezën simulative në kampus;
- Të bëhet ndarja e trajnimeve me kompetencë dhe trajnimeve që ofrohen gjatë shërbimit të cilat do mund të zhvilloheshin në kuadër të ISP-ve respektive;
- Të bëhet harmonizimi i ANT-se dhe mundësive në realizimin e trajnimeve sipas planit vjetor të trajnimeve:
  - Të jetesohet mandati i trajnimeve në kuadër të Akademisë me të gjitha pjesët përberëse të saj duke filluar nga analiza e nevojave për trajnim, planifikim dhe organizim të trajnimeve, zhvillim të kurrikulave e gjere tek shërbimet jashtë-kurrikulare të cilat janë shumë për tu dëshiruar;

Shtojca 1- Taksonomia e Bloomit

**Foljet aktive themelore të zhvillimit të trajnimit sipas taksonomisë së Bloom-it**

Njohja		Të kuptuarit		Të zbatuarit		Analiza		Sinteza		Vlerësimi / krijimi	
		Niveli 3		Niveli 4 & 5		Niveli 6					
		Trajnimi Themelor		Trajnimi i Avancuar		Trajnimi i Specializuar		Trajner per trajner			
Define, Identify, Describe, Recognize, Tell, Memorize, Quote, State, Match, Recognize, Select, Examine, Locate, Recall, Enumerate, List, Copy, Tabulate, Duplicate, Discover,	Përcakton, Identifikon, Përshkruan, Njeh, Tregon, Mban mend, Citim, Shteti, Pershtat Njohn, Zgjdh, Ekzaminon, Gjen, Kujtoj, Numëro, Listë, Kopjo, Nderlidh, Dublikon, Zbulon,	Summarize, Interpret, Classify, Compare, Contrast, Infer, Relate, Paraphrase, Cite, Discuss, Distinguish, Extend, Predict, Indicate, Translate, Associate, Explore Convert Express, Differentiate,	Përmbledh, Interpreton, Klasifikon, Krahason, Kontrast, Konkludon, Lidh, Parafrazon, Citon, Diskuton, Dallon, Zgjeron, Parashikon, Tregon, Përkthe, Bashkëpunëtor, Eksploron Konverton Shpreh, Diferencon,	Solve, Change, Relate, Complete, Use, Sketch, Discover, Show, Demonstrate, Dramatize, Produce, Prepare, Manipulate, Apply, Illustrate, Choose, Interpret, Experiment, Modify, Construct,	Zgjdh, Ndryshon, Nderidh, Ploteson, Përdor, Skicon, Zbulon, Shfaq, Demonstron, Të dramatizon, Prodhon, Përgatit, Manipulon, Aplikon, Ilustron, Zgjdhni, Interpreton, Eksperimenton, Modifikon, Ndërton,	Contrast, Connect, Classify, Distinguish, Infer, Order, Separate, Point-out Survey, Subdivide, Appraise, Break Down, Divide, Advertise, Categorize, Prioritize, Differentiate, Select, Explain, Analyze,	Ben kontrast, Lidh, Klasifikon, Të dallojë, Konkludoj, Porosit, Ndan, thekson Anketon, Nënndan, Vlerëson, Zbërthen, Ndan, Reklamon, Kategorizon, Prioritetizon, Diferencon, Zgjdh, Shpjegon, Analizon,	Criticize, Defend, Appraise, Evaluate, Judge, Support, Compare, Decide, Recommend, Summarize, Access, Choose, Convince, Defend, Estimate, Find errors, Grade, Measure, Predict, Rank,	Kritikon, Mbron, Vlerëson, Vlerësoni, Gjykon, Mbështet, Krahason, Vendos, Rekomandon, Përmbledh, Qaset Zgjdh, Bind, Mbron, Përafron, Gjen gabime, Gradon, Matë, Parashikon, Rendit,	Design, Modify, Role-Play, Develop, Rewrite, Pivot, Modify, Collaborate, Invent, Write, Re-write, Formulate, Imagine, Generalize, Integrate, Plan, Hypothesize, Substitute, Constructs,	Dizajnon, Ndryshon, Luan rol, Zhvillon, Rishkruan, Pivot, Modifikon, Bashkëpunoni, Shpik, Shkruan, Rishkruan, Formulon, Imagjinon, Përgjithëson, Integron, Planifikon, Hipotetizon Zëvendëson Ndërton